VENDIM
Nr. 168, datë 18.12.2012

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "HEC VLUSHE" SHPK PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 10 pika 1 dhe 11 të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P "Për prodhimin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për lënien peng të aseteve si kolateral nga shoqëria "Hec Vlushe" sh.p.k. pranë Bankës Kombëtare Tregtare, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Vlushe" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit" si më poshtë:

- Neni 7 pika 1.1 dhe 1.2. Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.)

- Neni 7 pika 1.3 germa "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h". Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetit e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)
- Neni 7 pika 2, 3, 4 dhe 5. (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë "Hec Vlushe" sh.p.k. për lënie peng si kolateral të 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani